

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

14.12.2020

Ora 17:37

RENDI I DITËS

Projektakti “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, N.Mezini**
- **Parti Politike PD, LSI**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Përshëndetje, nisim mbledhjen e Komisionit Rregullator të datës 14.12.2020. Mbledhja është thirrur nga ana e Kryetarit të Rregullatorit, pas njoftimit për vënien në lëvizje nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Janë të pranishëm në mbledhje të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, Drejtori i IT-së i KQZ-së dhe me sa po shoh unë kemi një përfaqësues, zëvendësues madje të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

PD-së akredituar pranë KQZ-së. Rendi i ditës i kësaj mbledhje përbëhet vetëm nga një çështje për shqyrtim dhe miratim. Bëhet fjalë për një akt për shqyrtim dhe miratim dhe konkretisht projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Duhet thënë që prej disa vitesh dhe disa palë zgjedhesh tashmë është një kriter teknik që përdoret në vendet e numërimit të votave (VNV). Pra pikërisht vendosja e kamerave monitoruese dhe vendosja e ekraneve në të cilat shfaqet fleta e votimit. Nga ana tjetër kemi dhe një sistem të monitorimit direkt të këtyre kamerave dhe monitorëve në KQZ dhe pikërisht sot nëpërmjet këtij projektvendimi ne synojmë që të vendosim dhe në këto zgjedhje kamerat monitoruese në VNV-të si dhe ekranet ku shfaqet fleta e votimit. Lidhur me këtë projektvendim, unë do të kërkoja nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ose nga një përfaqësues tjetër të administratës së KQZ-së, për të na paraqitur në detaje relacionin si dhe nevojën e miratimit të këtij projektvendimi, ju dëgjojmë Komisioner, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Mirëmbërëma të gjithëve dhe njëherë! Sikurse është parashtruar dhe në relacionin që ju është dërguar bashkë me projektaktin, ky akt vjen në bazë dhe në zbatim të nenit 94, paragrafi 4 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit përcaktohet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos përdorimin e kamerave regjistruese me rezolucion të lartë dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre në vendin e numërimit të votave (VNV), të cilat instalohen për çdo tavolinë të numërimit të fletëve të votimit. Pra, çdo grup numërimi i fletëve të votimit në VNV si të thuash është i mbikqyrur në veprimtarinë e vet nga një kamera e cila mundëson leximin qartësisht të fletës së votimit dhe në këtë mënyrë të rezultatit të votimit. Regjistrimi filmik i këtij procesi

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

transmetohet në kohë reale në monitorët të cilët janë të vendosur në ambjentet e numërimit të votave, në mënyrë të tillë që lehtësisht të jenë të shikueshëm nga përfaqësues të partive politike dhe subjekteve të ndryshme zgjedhorë, po kështu dhe nga vëzhgues dhe përfaqësues të medias. Kemi parashikuar që i njëjti informacion që transmetohet në VNV të jetë i transmetueshëm në kohë reale dhe në ambjentet e KQZ-së për të patur me këtë rast një mundësi më shumë për të kontrolluar dhe mbikqyrur gjithë procesin e numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit. Ky akt është në kompetencë të Komisionit Rregullator, pasi është një akt normativ i cili lidhet me një aspekt të rëndësishëm të procesit zgjedhor siç është procesi i nxjerrjes së rezultatit. KQZ-ja dhe administrata ka vlerësuar që ky proces nga pikëpamja teknike të realizohet nga të tretë, pasi KQZ-ja nuk e ka kapacitetin për ta zhvilluar vetë këtë proces. Në këtë mënyrë është proceduar dhe në zgjedhjet e vitit 2019 dhe pjesërisht dhe në zgjedhjet e vitit 2017. Paisjet të cilat KQZ disponon aktualisht në inventarin e vet janë të vitit 2009 dhe një pjesë e tyre janë të papërdorëshme. Në zgjedhjet e vitit 2017, nqs nuk gabo, vetëm 30-35% e atyre paisjeve janë përdorur dhe pjesa tjetër është vënë në dispozicion nga operatorët privatë, të cilët kanë mundësuar realizimin e këtij procesi nga pikëpamja teknike. Për këto zgjedhje ligji ka përcaktuar dhe një specifikë, pasi kërkon që të përdoren kamera me rezolucion të lartë të cilat sot për sot nuk gjenden në inventarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duke qenë se ky proces nga pikëpamja teknike do të realizohet nëpërmjet operatorëve të tjerë, jo nga personeli i KQZ-së, ne kemi propozuar edhe lejen për autorizimin nga ana e Komisionit Rregullator për këtë proces, faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi! Do t'u drejtohem anëtarëve të Komisionit Rregullator së pari, më tej përfaqësuesve të partive politike parlamentare, për të bërë komente, në parim lidhur me projektaktit, pasi është një akt që janë njohur dhe më

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

herët. Të nderuar kolegë, unë çel diskutimin në parim, fjala së pari është për ju për t'i drejtuar pyetje Komisionerit, administratës, apo për të bërë komentet tuaja dhe më pas fjala është për përfaqësuesit e partive politike parlamentare. Me sa po shoh, anëtarët e Rregullatorit nuk kanë diskutime në parim lidhur me projektaktin e paraqitur. Ftoj përfaqësuesit e partive politike zoti Kazia dhe zoti Nuraj, nëse keni diçka.

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Nuk kemi komente dhe asnjë kundërshtim, e nderuar!

Znj.I.Nano: Faleminderit! Zoti Nuraj a keni diçka në parim për projektaktin ju lutem?

Z.L.Nuraj, përfaqësuesi i PD-së: Jemi njohur me materialin që na keni dërguar nuk kemi asgjë.

Znj.I.Nano: Faleminderit! Duke qenë se as anëtarët e Rregullatorit dhe as përfaqësuesit e partive politike nuk kanë ndonjë diskutim konkret, unë ftoj anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë në parim projektaktin siç është paraqitur.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet në parim projektaktin.

Kalojmë në diskutimin për çdo pikë. Projektakti sikurse ka ardhur i paraqitur nga administrata ka disa pika. Komisioni Rregullator Vendosi:

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

Pika 1 Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve), për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit, në vendin e numërimit të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Referuar rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e punës së Komisionit Rregullator” në diskutimin nen për nen, ose pikë për pikë më së pari i jepet fjala përfaqësuesve të partive politike. Zoti Kazia, zoti Nuraj për pikën e parë keni ndonjë propozim konkret, shtesë, ndryshim?

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Jo nuk kemi!

Z.L.Nuraj, përfaqësuesi i PD-së: Jo!

Znj.I.Nano: Me sa shoh nuk kemi diskutime, ftoj kolegët të votojmë pikën 1 të projektvendimit sipas projektit të sjellë nga Komisioneri.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet pika 1!


Pika 2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga VNV në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Përfaqësuesit e partive?

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Jo e nderuar!

Znj.I.Nano: Zoti Nuraj keni ndonjë propozim?

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

Z.L.Nuraj, përfaqësuesi i PD-së: Jo!

Znj.I.Nano: Faleminderit! Anëtarët e Rregullatorit për pikën e dytë të projektvendimit?

Znj.H.Vukaj: Për këtë pikë jo, por pas kësaj pike kam një propozim!

Znj.I.Nano: Votojmë pikën 2 të projektaktit!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundër: S'ka

Miratohet pika 2 e projektaktit!

Zonja Vukaj më thatë që pas pikës 2 keni një propozim konkret, po ju dëgjojmë!

Znj.H.Vukaj: Akti vërtet është një akt le të themi “përsëritës”, pra është akt që gjenerohet prej disa zgjedhjeve. Është një akt i rëndësishëm pavarësisht se në anën e tij sasiore e shohim që ka një sasi të vogël pikash, por është tejet i rëndësishëm për shkak se garanton parimin e transparencës dhe sigurinë juridike dhe ligjore të këtij procesi. Nga ana tjetër ky akt do të doja të mos mbetej në kushtet, në parim thjesht të lejimit të implementimit të kësaj transparence përmes teknologjisë IT, apo teknologjisë së avancuar. Do të doja që pas pikës 2, ne të rrisnim dozën e garancisë për të gjithë aktorët dhe për të gjithë instrumentët e përfshirë në këtë proces. Për më tepër për të garantuar vullnetin e lirë të zgjedhësve. Konkretisht propozimi im i përfshin pikën 1 dhe pikën 2 duke thënë në një pikë të re se “përdorimi i kamerave regjistruese dhe i monitorëve si dhe përdorimi i sistemit video-monitorimit, të bëhet

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020

në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të KQZ-së”. Pra, ne t’i lemë hapur rrugën dhe njëkohësisht na lind si detyrë të nxjerrim një akt tjetër i cili do të normojë dhe do të standartizojë më tej se si do të përdoren dhe se si do të ruhen, apo si do të sistemohen këto mekanizma transparence. Në këtë kuadër ne i shërbejmë abolutisht publikut, jo vetëm fizikisht përmes prezencës së këtyre mjeteve dhe punës që ato kryejnë, por dhe juridikisht. Për faktin se në një moment ato shndërrohen dhe marrin vlerë juridike siç mund të jetë ankimimi, siç mund të jetë një proces në gjykatë e kështu me rradhë. Propozimi im është që ne t’ia lemë rrugën hapur akteve të tjera të cilat do ta përmirësojnë, ose do të rrisin garancinë për përdorimin e këtyre mjeteve, faleminderit.

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj faleminderit, unë do t’ia jap fjalën të gjithë anëtarëve të Rregullatorit dhe përfaqësuesve të partive politike. Personalisht po e marr fjalën menjëherë pas jush duke ju mbështetur në propozimin tuaj. Më duket jo thjesht me shumë vend, por dhe një detyrim që buron nga Kodi Zgjedhor. Pikërisht është neni 22, pika 3 “Përdorimi i sistemeve, ose paisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme, lidhur me procedurat dhe aspektet e veçanta të procesit që mbulohen nga këto sisteme, apo paisje”. Pikërisht detyrimin që ne të miratojmë rregulla të tjera procedurale me akt normativ përcaktohet në fjalinë e fundit të nenit 22, pika 3 “rregullat procedurale për sigurinë, miratohen me akt normativ të KQZ-së”. Personalisht do të doja t’u mbështesja jo thjesht me votë, por edhe duke e sqaruar mbështetjen lidhur me propozimin tuaj. Për procedurë po u drejtohem përfaqësuesve të partive politike dhe më tej dhe anëtarëve të Rregullatorit. Zoti Kazia, zoti Nuraj lidhur me propozimin e zonjës Vukaj?

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Jemi dakord me propozimin e zonjës Vukaj!

Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

Znj.I.Nano: Zoti Çaka, zoti Çela, zoti Çakaj, keni ju ndonjë diskutim lidhur me propozimin e zonjës Vukaj?

Z.M.Çakaj: Jam dakord, ishit shumë shterruese ju me argumentat e dhënë.

Z.D.Çaka: Dakord, është me vend shtimi i kësaj pike.

Znj.I.Nano: Votojmë propozimin e zonjës Vukaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Do t'i lutesha zonjës Vukaj që për arsye të zbardhjes së vendimit ta rilexonte dhe njëherë, që administrata që në këtë moment mban shënime ta ...

Znj.H.Vukaj: Po, por vetëm pranoni kushtet në të cilat ndodhemi. Po e rilexoj dhe për saktësi po e dërgoj me shkrim. **Pika 3.** Përdorimi i kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) si dhe përdorimi i sistemit video-monitorimit, të bëhet në bazë të rregullave proceduriale të miratuara me akt normativ të KQZ-së.

Znj.I.Nano: Personalisht mua më duket se është plotësisht në përputhje me nenin 22, pika 3. Vazhdojmë me pikën 3 sipas projektit të propozuar nga Komisioneri që tani kalon si pika 4, parashikohet si më poshtë.

Pika 4. Shërbimi i kamerave regjistruese dhe i monitorëve (ekraneve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga VNV në ambjentet e KQZ-së sipas

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi kryehet nga operatorë të kontraktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

Do të ftoja së pari përfaqësuesit e partive politike në se kanë ndonjë koment, shtesë, ndryshim, propozim në këtë pikë dhe më tej anëtarët e Rregullatorit.

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Jam dakord!


Znj.I.Nano: Zoti Nuraj!

Z.L.Nuraj, përfaqësuesi i PD-së: Dakord!

Znj.I.Nano: Anëtarët e Komisionit Rregullator? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Në lidhje me këtë pikë, në rradhë të parë do të doja të bëja një pyetje në lidhje me faktin që... fillon formulimi i kësaj pike me termin “Shërbimi i kamerave regjistruese dhe i monitorëve...”. Pyetja ime është që bëhet fjalë për shërbimin e paisjeve apo të përdorimit të paisjeve. Pra, këtë nuk arrij ta kuptoj shumë qartë unë. Kur themi shërbimi i kamerave regjistruese dhe i monitorëve në ekranet e sistemit të transmetimit. Pra, bëhet fjalë për marrjen e këtyre paisjeve që do të bëhet nga operatorë të kontraktuar, apo përdorimi i tyre? Pse e bëj këtë pyetje? E bëj këtë pyetje sepse ashtu siç shoh dhe bazën ligjore tek pjesa arsyetuese e projektvendimit me të drejtë është parashikuar neni 23, paragrafi 1 i ligjit. Në qoftë se do t’i referohemi nenit 23, paragrafi i Kodit Zgjedhor thotë “sistemet, apo paisjet e Teknologjisë së Informacionit në zgjedhje vihen në përdorim nga personeli i kualifikuar i KQZ-së, i punësuar për këtë qëllim, përveç kur Rregullatori..”, pra kjo është kompetencë e jona “..vendos që përdorimi i tyre të bëhet nga operatorë privatë”. Pra, pyetja ime është

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

konkretisht kjo pikë ka të bëjë vetëm me përdorimin e këtyre paisjeve, apo edhe me marrjen e këtyre paisjeve që do të bëhet nga kontraktorë të tretë?

Znj.I.Nano: Pyetjen ia drejtoni Komisionerit, Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të IT-së?

Z.D.Çaka: Mbase të treve, por nuk e di se kush mund të më japë një përgjigje, është pjesë teknike më shumë, apo pjesë e administrimit në nivel drejtues.

Z.I.Celibashi: Meqenëse kjo lidhet më shumë me interpretimin dhe kuptimin juridik të asaj pike, gjeni këtë shpjegi. Aty bëhet fjalë thjesht., pra kjo pikë lidhet thjesht me lejimin e përdorimit nga operatorë privatë të kontraktuar të paisjes së sistemit. Nuk është një kërkesë për leje për të prokuruar vetë paisjen, apo sistemin. Edhe pse fjalia e dytë e pikës 1 mund të lejojë që ai që është dhe furnizues i këtyre paisjeve, të jetë edhe ai që e realizon shërbimin. Në rastin konkret kërkesa për leje nga Rregullatori ka të bëjë me lejimin e operatorëve privatë për të përdorur këto sisteme. Pra, nuk është leje për t'u prokuruar.

Z.D.Çaka: Mund të bëj atëherë një propozim për riformulim në se më pas komisioni do të ishte dakord që në vend të termit “shërbimi kamerave” të zëvendësohej ky term me “përdorimi i kamerave regjistruese dhe monitorëve në ambjentet e KQZ-së kryhet nga operatorë sipas akteve nënligjore...”. Pra vetëm termi “shërbimi” të zëvendësohet me termin “përdorimi”. Ky është propozimi im. Duke qenë se ishte në përgjigje të pyetjes time, ishte shumë shterruese përgjigjia e Komisionerit që kemi të bëjmë me përdorimin. Unë mendoj të zëvendësojmë fjalën shërbimi me përdorimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

Znj.I.Nano: Propozimi i zoti Çaka është që në pikën 3 të propozimit që tashmë shkon pika 4 e projektaktit fjala “shërbimi” të zëvendësohet me fjalën “përdorimi”. Ky është një propozim. Propozime të tjera për këtë pikë kemi para se ta votojmë. Duke qenë se pyetja e zotit Çaka nëpërmjet përgjigjes së Komisionerit, besoj se e adresuan problematikën e ngritur, unë mendoj që të votojmë propozimin e zotit Çaka. Në pikën 4 të projektvendimit fjala “shërbimi” të zëvendësohet me fjalën “përdorimi”.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çaka?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet pika 4 e projektvendimit sipas këtij propozimi!

Pika 4 e projektit të ardhur nga Komisioneri tani është pika 5

Pika 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Po e kaloj në votim, sepse nuk besoj se ka ndonjë shtesë, propozim, apo sugjerim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Pika 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet pika 6!

Kemi shqyrtuar, miratuar në parim dhe miratuam pikë për pikë projektvendimin “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.14.12.2020*

votimit në vendet e numërimit të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Janë votuar dy propozime për ndryshime ai i zonjës Vukaj për shtesën e pikës 3, pas pikës 2 të projektvendimit dhe propozimi i zotit Çaka për një ndryshim në pikën 4, ish pika 3 e projektvendimit. I theksoj dhe njëherë për efekt të zbardhjes së projektvendimit me ndryshimet. Është momenti të votojmë në tërësi projektvendimin.

Kush është dakord me projektvendimin sipas gjithë ndryshimeve të paraqitura dhe votuara tashmë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet në tërësi vendimi!

Falenderoj për pjesëmarrjen të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e IT-së të KQZ-së, si dhe përfaqësuesit e partive politike të pranishëm në këtë mbledhje. Në përfundim do të theksoja se ky akt që sapo miratuam është mjaft i rëndësishëm, veçanërisht edhe pas ndryshimeve të propozuara për të siguruar një transparencë maksimale në një nga proceset më të rëndësishme në kuadër të gjithë procesit që do të zhvillohet nga data 25 prill 2021 e në vijim, procesit të numërimit të votave, ju falenderoj dhe njëherë duke deklaruar mbledhjen të mbyllur, natën e mirë!

Vendimi nr.8

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***

